Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**29.08.2023**	**14.09.2023**	**2023/0611**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.08.2023, OE “INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0611, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË” me nr. të prokurimit: "214-23-5718-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0611 i dt:24.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

NENI 108/A

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar dhe kemi plotësuar kërkesen e DT dhe me datë 15.08.2023 për

qudi kemi marrë vendim për tenderuesin e eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar foto apo dëshmi të

mjaftueshme, por ju me qëllim të dëmtimi të Kompanis tonë nuk keni kërkuar sqarime kurse keni përdorur

standarte të dyfishta pasi që për OE e rekomanduar për kontratë.

Përdorimi i standarteve të dyfishta përderi sa OE të rekomanduar keni kërkuar sqarime lenë për të dyshuar

se ka keqperdorime në këtë AP ne pas qasjes jemi duke anliazuar Oferten e OE dhe brenda affatit ligjorë,do

e plotësojm atë.

Arsyetimet e AK se nuk kemi ofruar makineri të mjaftueshme është kejt se e pavërtet pasi që në oferten tonë

kemi bashkangjitur të gjitha dëshmit sipas kërkesave

dhe mungesa e fotove nuk permben ndonje shkelje ligjore e cila ka mundur të sqarohet.

Arsyetimet tuaja janë kerjtesisht të pabazuara

Pas analizë së ofertave ne pamë që OE i rekomanduar ka ofruar një Marrëveshje me një biznes smajl

Jakupaj B.I. me nr 810448557 i cili del të jetë i shuar dhe dokumenti i tilë llogaritet si mashtrim dhe eshte jo

valid që e bënë oferten të papërgjegjëshme.

I Nderuar Panel shqyrtues neve kemi dorëzuar kërkesen për ri-shqyrtim dhe konform rregulloreve e kemi

plotesuar atë por AK me qellim te fshehjes se manipulimeve të tyre e ka kthyer gjoja se nuk kemi vendosur të

dhwnat gjë që është e pavertet dhe e pa mundur sepse ne nuk kemi mundesi te nderhym ne sistem dhe pse

nuk kan dalur te dhene e tona ne kerkes per ri-shqyrim mund te jete vete mosfunksionim i sitemit por perderi

sa kan shkuar nga USERI(PERDORUESI) jonë atëhere për AK janë të njoftura ko të dhëna.

Bazuar në rregullore dhe afate ligjore konform LPP ne do e plotesojm ankesen

Kërkojm që të aprovoni ankesen tonë dhe lënden ta ktheni në rivlerësim

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(NJOFTIM 21.08.2023)

NJOFTIM

Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K. Rr.Garibaldi, Prishtin

Për aktivitetin e prokurimit:

"SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË"

me nr. Prok. 214-23-5718-2-1-1

Ju njoftojme lidhur me kerkesen per rishqyrtim te dates 21.08.2023 për tenderin "SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË"me nr. Prok. 214-23-5718-2-1-1,

Bazuar ne:

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nenin 60 paragrafi 60.3.

60.3 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë:
a. emrin, adresën postare, adresën elektronike, dhe informatat e kontaktit të parashtruesit të ankesës;
b. emrin e autoritetit kontraktues në fjalë;
c. një përshkrim specifik të arsyeshëm të aktivitetit të prokurimit;
d. bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar;
e. Demonstron se parashtruesi i ankesës kualifikohet si një "palë e interesuar," sikurse përkufizohet nën nenin 4 të ligjit;
f. Përshkruan rrethanat faktike që përbejnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar;
g. Specifikon dispozitën apo dispozitat e LPP-së që pretendohet se janë shkelur; dhe
h. Përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktojë, dëm material parashtruesit

(NJOFTIMI PER HUDHJE TE KERKESES)

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme MinistarstvoUnutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police	
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

NJOFTIM
Për aktivitetin e prokurimit:
"SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË"
me nr. Prok. 214-23-5718-2-1-1

Ju njoftojmë qe me date 21.08.2023 Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K. Rr.Garibaldi, Prishtin ka bere kerkese për rishqyrtim e cila kërkesë nuk ka qene e plotesuar sipas:
RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK nenin 60 paragrafi 60.3.
OE-ne e kemi njoftuar sipas nenit 61.2 qe ta plotësoj kërkesën bazuar ne nenin 60.2
OE ka dështuar te veproj sipas kërkesës se parapare andaj kërkesa për rishqyrtim i hidhet si e paplotë (neni 61.2).

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Kerkesa per sqarim dhe pergjigjet e KRPP-sw:

Te nderuar,

Lidhur me e-mailin dhe kerkesen si me poshte, nga perspektiva e sistemit te prokurimit elektronik ju ofrojme sqarimet si ne vijim:

- Autoriteti kontraktues ne kuader te detajeve te procedures - folderit "Dokumentet-Letrat Standarde" ka opsionin qe pervec letrave standarde te dergoj edhe cfaredo dokumenti tek OE, perfshire edhe dokument/kerkese qe ka te beje me "kerkese per rishqyrtim"

- Gjate pergaditjes se "kerkeses per rishqyrtim" nga ana e OE, ne hapat perkates apo ne hapin e 3-te " Identifikimi i OE", sistemi automatikisht plotëson të dhënat e OE. Kjo pjese eshte e sqaruar edhe ne manualin per OE rreth pergaditjes dhe dorezimit te kerkeses per rishyrtim. Nese te dhenat e hapave te pergaditjes se kerkeses per rishyrtim nuk jane shfaqur ne dokumentin e kerkeses per rishqyrtim te krijuar ne hapin e 9-te, atehere kjo eshte pasoje e sistemit gjate krijimit te dokumentit ne hapin perkates.

Sidoqofte, ne lidhje me kete pjese apo ne momentin e krijimit te kerkeses per rishyrtim, Manuali per OE rreth pergaditjes dhe dorezimit te kerkeses per rishyrtim, keshillon OE si ne vijim: *"Kërkesa për rishqyrtim" duhet të shkarkohet me qëllim për të kontrolluar të dhënat e shënuar në hapat paraprak (nëse kërkesa e krijuar përmbanë të gjitha të dhënat në formë të saktë), dhe nuk kërkohet që kërkesa të nënshkruhet dhe vuloset nga ana e OE. Pra, vetem kontrollohen të dhënat dhe nëse të gjitha të dhënat janë të sakta, atëherë vazhdon nëpërmjet butonit "Ruaj dhe vazhdo". Nëse, OE dëshiron t'a ngarkoj "Kërkesën për rishqyrtim" të nënshkruar dhe çfarwdo dokumente të tjera mbështetëse të "Kërkesës për rishqyrtim" atëherë këtë mund ta bëj duke përdorur butonat "Ngarko".* ?

Me respekt !

HelpDesk

+381 038 200 82 000

https://e-prokurimi.rks-gov.net

Departamenti i Teknologjisë Informative

Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik

https://krpp.rks-gov.net

#VAKSINOHU

P Save paper.....think before you print?

From: Ilir Halili
Sent: Wednesday, September 13, 2023 8:46 AM
To: Eprokurimi Helpdesk; Rregullat Krpp
Cc: Vjosa Gradinaj; Shqipe Hoti
Subject: RE: Kerkese per sqarim

Rikujtim.

From: Ilir Halili
Sent: Monday, September 11, 2023 11:19
To: Eprokurimi Helpdesk <Eprokurimi.Helpdesk@rks-gov.net>; Rregullat Krpp <rregullat.Krpp@rks-gov.net>
Subject: Kerkese per sqarim

Te nderuar,

Ne cilesi te ekspertit shjqyrtues te OSHP-se po ju drejtohemi me kerkese per sqarim lidhur funksionimin e E-Prokurimi, nga kendveshtrimi i Operatorit Ekonomik .

Ne rastin konkret AK, tek rubrika "Dokumentet - Letrat standarde" ka ngarkuar dokumentin e titulluar "Njoftim 21.08.2023":

Brenda ketij njoftimi AK kerkon nga OE plotesimin e kerkeses per rishqyrtim dhe pas dy diteve e ka refuzuar kerkesen per rishqyrtim pasi kerkesa nuk permban te dhenat e OE siq parashihet me nenin 60.3 te rregullores 01/2022.

OE ankues pretendon se nuk kane mundesi te nderhyjne ne permbajtjen e te dhenave te OE, dhe se kjo mund te jet mosfunksionim I sistemit.

Arsyetimi I OE:

I Nderuar Panel shqyrtues neve kemi dorëzuar kërkesen për ri-shqyrtim dhe konform rregulloreve e kemi

[redacted]

plotesuar atë por AK me qellim te fshehjes se manipulimeve të tyre e ka kthyer gjoja se nuk kemi vendosur të dhwnat gjë që është e pavertet dhe e pa mundur sepse ne nuk kemi mundesi te nderhym ne sistem dhe pse nuk kan dalur te dhene e tona ne kerkes per ri-shqyrim mund te jete vete mosfunksionim i sitemit por perderi sa kan shkuar nga USERI(PERDORUESI) jonë atëhere për AK janë të njoftura ko të dhëna.

Bazuar në rregullore dhe afate ligjore konform LPP ne do e plotesojm ankesen

Fillimisht ju lusim te na sqaroni se a eshte kjo (Njoftimi i vendosur tek "Letrat standarde") forma e duhur per te kerkuar nga OE plotesimin e kerkeses per rishqyrtim.

Po ashtu ju lusim te na informoni se te dhenat e OE ne kerkese per rishqyrtim ne faqe te pare, siq jane emri i OE, adresa postare, adresa elektronike etj, a plotesohen nga vet OE apo gjenerohen nga vet sistemi/useri i OE.

Me qene se dihet emri I OE qe ka paraqitur kerkese per rishqyrtim, siq mund te shihni me poshte ku emri shenon tek "Ofertuesi", a konsideroni se eshte arsye valide per refuzim te kerkeses mungesa e te dhenave te OE (emri, adresa etj) brenda vet dokumentit/kerkeses per rishqyrtim.

Me respekt

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.611/23 ka të bëjë me "Njoftimin" e AK-PK, përmes së cilit AK e ka hedhur sit ë paplotë kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

AK-PK fillimisht pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim 21.08.2023, pasi kanë vërejtur se në kërkesën në fjalë-në vet dokumentin/kërkesën për rishqyrtim në faqe të parë mungojnë të dhënat e OE, siq janë emri, adresa postare etj…, përmes E-Prokurimi në rubrikën "Dokumentat-Letrat Standarde" ka ngarkuar një njoftim duke cituar dispozitat e nenit 60.3 të rregullores 001/2022 për prokurim publik, e cila dispozitë përcakton të dhënat që duhet të përmbaj ankesa.

Provë: E-Prokurimi-Letrat standarde "Njoftim 21.08.2023"

Me 23.08.2023 AK-PK e hedh kërkesën në fjalë si jo të plotë duke u thirrur në nenin 61.2 të rregllores "*…Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishqyrtim do të refuzohen si e paplotë.*

OE ankues pretendon se i njëjti e ka të pamundur të ndërhyjë në të dhënat që shfaqen :

"*…**ne nuk kemi mundesi te nderhym ne sistem** dhe pse nuk kan dalur te dhene e tona ne kerkes per ri-shqyrim **mund te jete vete mosfunksionim i sitemit** por perderi sa kan shkuar nga USERI(PERDORUESI) jonë atëhere për AK janë të njoftura ko të dhëna".*

Me qenë se nga pozicioni I ekspertit shqyrtues të OSHP-së nuk jemi të njfotuar me detajet se si funksionon sistemi eprokurimit nga pozicioni I Operatorit ekonomik, ne kemi kërkuar sqarime nga KRPP.

Provë: Kërkesa jonë përsqarime drejtuar KRPP-së dhe përgjigjet e KRPP-së.

Në përmbledhje kemi kërkuar sqarime se a është bërë kërkesa e AK-së për plotësim në formën e duhur dhe a ka mundësi OE të ndëryje në të dhënat që shfaqen ne kërkesë/faqe të parë.

Nga KRPP me datë 13.09.2023 kemi pranuar përgjigje se :

*"Autoriteti kontraktues ne kuader te detajeve te procedures - folderit "Dokumentet-Letrat Standarde" ka opsionin qe **pervec letrave standarde te dergoj edhe cfaredo dokumenti tek OE, perfshire edhe dokument/kerkese qe ka te beje me "kerkese per rishqyrtim"***

*- Gjate pergaditjes se "kerkeses per rishqyrtim" nga ana e OE, ne hapat perkates apo ne hapin e 3-te " Identifikimi i OE", sistemi automatikisht plotëson të dhënat e OE. Kjo pjese eshte e sqaruar edhe ne manualin per OE rreth pergaditjes dhe dorezimit te kerkeses per rishyrtim. **Nese te dhenat e hapave te pergaditjes se kerkeses per rishyrtim nuk jane shfaqur** ne*

dokumentin e kerkeses per rishqyrtim te krijuar ne hapin e 9-te, ***atehere kjo eshte pasoje e sistemit gjate krijimit te dokumentit ne hapin perkates ".***

Po ashtu në fund të përgjigjes së KRPP thuhet se :

"Sidoqofte, ne lidhje me kete pjese apo ne momentin e krijimit te kerkeses per rishyrtim, Manuali per OE rreth pergaditjes dhe dorezimit te kerkeses per rishyrtim, keshillon OE si ne vijim: *"Kërkesa për rishqyrtim" duhet të shkarkohet me qëllim për të kontrolluar të dhënat e shënuar në hapat paraprak (nëse kërkesa e krijuar përmbanë të gjitha të dhënat në formë të saktë), dhe nuk kërkohet që kërkesa të nënshkruhet dhe vuloset nga ana e OE. Pra, vetem kontrollohen të dhënat dhe nëse të gjitha të dhënat janë të sakta, atëherë vazhdon nëpërmjet butonit "Ruaj dhe vazhdo". Nëse, OE dëshiron t'a ngarkoj "Kërkesën për rishqyrtim" të nënshkruar dhe çfarëdo dokumente të tjera mbështetëse të "Kërkesës për rishqyrtim" atëherë këtë mund ta bëj duke përdorur butonat "Ngarko".*

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, njoftimeve të AK-së dhe ne veqanti sqarimeve të ofruara nga KRPP, japim vlerësimet tona si në vijim:

Mungesa e të dhënave të OE (emri, adresa postare, adresa elktronike, numri tel) në brendi të dokumentit/kërkesës faqe të parë, nuk ka ndodhur me fajin e OE ankues, këto të dhëna sipas sqarimeve të KRPP plotësohet automatikisht nga sistemi.

Sipas sqarimit të KRPP, autoriteti kontraktues "*ka opsionin qe* ***pervec letrave standarde te dergoj edhe cfaredo dokumenti tek OE****, perfshire edhe* ***dokument/kerkese qe ka te beje me "kerkese per rishqyrtim****".*

Në rastin konkret AK-PK nuk ka dërguar tek OE "Kërkesë" për plotësim, dhe ka ngarkuar "Njoftim" në rubrikën "Dokumentet Letrata Standarde".

Neni 61.2 i rregullores ndër tjera thotë "...*Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit,* ***do të kërkojë nga aplikuesi*** *që* ***të plotësoj kërkesën e tij****..".*

Në "Njoftimin" e AK-PK askund nuk "kërkohet" nga aplikuesi të "plotësoj" kërkesën e tij.

Provë : E Prokurimi - Letrat StandardeNjoftimi 21.08.2023

Në rastin konklret, mendimi ekspertit është se AK është dashtë që mënyrë të qart dhe koncize të dërgoj "kërkesë" për plotësim të kërkesës për rishqrytim.

AK në në këtë rast nuk ka dërguar "Kërkesë", e as nuk ka kërkuar "plotësim të kërkesës", siq parashihet me dispozitat e nenit 60.1 të rregullores 001/2022.

Në përgjigje/sqarime të KRPP-së po ashtu thuhet se në manualin për OE, të njëjtit "këshillohen" të shkarkojnë kërkesën për ta kontrolluar se mban gjitha të dhënat, megjithatë as nga sqarimet e KRPP e as nga njoftimet e AK-PK nuk ka ndonjë udhëzim se si mund të korrigjohen të dhënat e OE nëse ato janë të pasakta, pasi siç e kemi kuptuar gjatë shqyrtimit të kësaj ankese dhe përgjigjeve të KRPP , operatorët ekonomik nuk mund të ndërhyjnë në këto të dhëna dhe "***sistemi automatikisht plotëson të dhënat e OE***".

Bazuar në gjitha këto që u cekëm më lart, mendimi i ekspertit është se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 61.2 lidhur me nenin 60.3 të rregullores 001/2022, dhe OE ankues i është pamundësuar realizimi i të drejtës për Zgjidhje Preliminare e mosmarrëveshjeve sipas neni 108/A.

Mbi këtë bazë eksperti shqyrtues vlerëson se nuk kemi nevojë të lëshohemi në pretendimet tjera të OE ankues, dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në Rishqyrtim pranë AK-PK, me qëllim që AK-PK në pajtim me nenin 108/A të LPP-së të përgjigjet në gjitha pretendimet e OE ankues dhe të nxjerr "Vendim" mbi kërkesë për rishqyrtim në përputhje me dispozitat e LPP-së.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rishqyrtim dhe AK-PK të nxjerr vendim duke u përgjigjur në gjitha pretendimet ankimore të OE.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TEMA: RAZMATRANJE NABAVIKI REPUBLIKA KOSOVA